

## Titulli i lëndës: NORMË E SHQIPES SË FOLUR

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës Shqipe
Titulli i lëndës:	Normë e shqipes së folur
Niveli:	BA (Baçelor)
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I   Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+4
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:shpetim.elezi@uni-pr.edu">shpetim.elezi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Kursi <i>Norma e shqipes së folur</i> ofron bazën teorike e praktike të normës shqiptimore të shqipes standarde, si dhe elementeve prozodike të saj. Ky kurs u ofron studentëve shpjegimet dhe sqarimet e nevojshme teorike lidhur me përvetësimin dhe aplikimin e rregullave të drejtshqiptimit të gjuhës standarde shqipe. Ligjërimi me gojë është i nevojshëm për të gjithë për nevoja akademike dhe profesionale, andaj për të folur korrekt dhe pa gabime drejtshqiptimore është e domosdoshme që të mësohen parimet dhe rregullat ortoepike të shqipes standarde, që para së gjithash janë të natyrës fonetike. Kursi përfshin edhe elemente mbisegmentare, siç janë theksi, rrokja, intonacioni, pauzat, ritmi etj.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs synon t'i përgatitë studentët me dijen teorike për përdorimin praktik të gjuhës së folur. Pra qëllimi është që të ngrihen niveli dhe kultura e të shprehurit me gojë në domene e situata formale të komunikimit publik. Për këtë qëllim kursi përfshin parimet dhe rregullat ortoepike të normës së folur të shqipes standarde, si dhe dijen mbi elementet prozodike të të folurit për nevoja akademike e profesionale në komunikimin publik. Po ashtu kursi ka për qëllim që studenti të arrijë të identifikojë e të shpjegojë parimet dhe rregullat ortoepike të shqipes standarde.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• shqipton rrjedhshëm dhe pa gabime sipas elementeve ortoepike e prozodike të shqipes standarde.</li><li>• zbaton me konsekuencë të plotë rregullat drejtshqiptimore dhe elementet mbisegmentare gjatë komunikimit gojor në situata formale;</li><li>• identifikon gabimet e drejtshqiptimit dhe shmangiet nga norma e folur në domenet dhe situatat e komunikimit formal.</li><li>• shpjegon rregullat e normës së shqipes së folur.</li><li>• dallon shqiptimin normativ nga ai jonormativ të tingujve të shqipes standarde, duke mënjanuar variantet e shqiptimit jostandard në komunikimin formal.</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• analizon rregullat duke u bazuar në parimet e normës së shqipes së folur.</li> <li>• heton faktorët gjuhësorë e jashtëgjuhësorë që ndikojnë në moszbatimin korrekt të normës së shqipes së folur.</li> <li>• rekomandon lidhur me rregullat ortoepike të ligjërimit standard.</li> </ul>
--	---

#### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	22.5
Ushtrime	4	15	45
Përgatitje për test intermediar	3	4	12
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	3	4	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	10 min	15	2.5
<b>Totali</b>			149.5 orë 149.5:25=5.98 6 ECTS

**Metodat e mësimdhënies:** Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi. Mësimdhënia gjatë ligjëratave do të jetë e organizuar nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara. Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme e të paqarta. Studentët kanë punime seminari e punime të tjera me shkrim të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë në çifte e në grupe, si edhe hulumtime. Përmes projekteve e prezantimeve nxiten debate e diskutime midis tyre. Ndiqen edhe emisione në radio e TV, filma e shfaqje teatrale etj. dhe diskutohet për to.

**Metodat e vlerësimit:** Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 51%.  

- Vijueshmëria 10%
- Angazhimi 10%
- Kolokuiumi I 40%
- Kolokuiumi II 40%

Gjithsej 100%: 51-60% (6), 61-70 (7), 71-80 (8), 81-90 (9), 91-100 (10).  
**Shënim.** Për shkak të specifikave të lëndës, duke marrë për bazë edhe suksesin e arritur nga vlerësimi i vazhdueshëm, në fund të kursit studentët do t'i nënshtrohen *provimit me gojë* për të përcaktuar përfundimisht shkallën e arritshmërisë së tyre.

**Literatura primare:**

1. Anastas Dodi, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe. Tiranë, 2004.
2. Bahri Beci, Fonetika. Prishtinë, 2004.
3. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973.
4. Materialet nga ligjëratat dhe ushtrimet.

**Literatura shtesë:**

1. Ali Dhrimo – Rami Memushaj, Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë: Infobotues, 2011.
2. Anastas Dodi, Drejtshkrimi dhe shqiptimi letrar. Kongresi i Drejtshkrimit,

- vëll. I, Tiranë, 1973.
3. Anastas Dodi, Gjuha e folur letrare dhe norma e saj fonetike në etapën e sotme. Gjuha jonë, nr. 2, Tiranë, 1985.
  4. Anastas Dodi, Kultura e gjuhës dhe shqiptimi letrar. Gjuha jonë, Tiranë, 1981.
  5. Anastas Dodi, Ndarja aktuale e fjalisë dhe intonacioni në gjuhën shqipe. Gjuha jonë, nr. 4, Tiranë, 1986.
  6. Anastas Dodi, Rreth problemeve të drejtshqiptimit të gjuhës letrare shqipe. Studime filologjike, nr. 4, Tiranë, 1972.
  7. Anastas Dodi, Fusha e shpërndarjes së zanoreve dhe problemet e normës së shqiptimit. Gjuha jonë, nr. 1-4, Tiranë, 1986.
  8. Bardh Rugova, Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë. Prishtinë: ASHAK, 2019.
  9. Eqrem Çabej, Diftongje e grupe zanoresh të shqipes. BUSHT, SSHSH, 3, 1958, Tiranë.
  10. Fadil Sulejmani, Praktikum i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1981.
  11. Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë: ASHSH, 2006.
  12. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1976.
  13. Flutura Çitaku, Disa shmangie nga norma e gjuhës letrare në emisionet e Radio Tiranës. Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare sot”, Tiranë, 1992 (Tiranë, 2002) dhe në “Gjuha jonë”, 1/4, Tiranë, 1993.
  14. Flutura Çitaku, Gjuha e RTK-së. Seminari 19. Prishtinë, 2000.
  15. Flutura Çitaku, Ligjërimi i komentatorëve të Botërorit “Gjermania 2006”, Seminari 25/1, Prishtinë, 2006.
  16. G. Bevington, Albanian Phonology, Chicago, 1973.
  17. G. Bevington, Albanische Betonung im Lichte der generative Phonologie, Innsbruck, 1977.
  18. Gramatika e gjuhës shqipe, 1, 2, Tiranë: ASHSH, 2002.
  19. Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës. Tiranë, 2006.
  20. Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran. Tiranë, 1988.
  21. Gjovalin Shkurtaç, Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur. Tiranë, 1998.
  22. Gjuha jonë (revistë e botuar nga IGJL në Tiranë).
  23. Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë, 1976.
  24. Gjuha shqipe (revistë e botuar nga IA në Prishtinë).
  25. Isa Bajçinca, Shqipja standarde dhe probleme rreth saj. Prishtinë, 2016.
  26. Kolec Topalli, Theksi në gjuhën shqipe. Tiranë, 1995.
  27. Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973.
  28. Lumnie Boriqi, Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe. Studime filologjike, nr. 2, Tiranë, 1987.
  29. Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë: ASHRSH, 1998.
  30. Rami Memushaj, Shqipja standarde – Si ta flasim dhe ta shkruajmë. Tiranë, 2004.
  31. Rami Memushaj, Vendi i drejtshkrimit dhe i drejtshqiptimit në normat e gjuhës letrare. Gjuha jonë, Tiranë, 1984/1.
  32. Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (Projekt). Prishtinë: UP, 1967.
  33. Zijadin Munishi, Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit. Prishtinë, 1984.

#### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Përshkrimi i silabusit. Hyrje në normë të shqipes së folur.
Java 2:	Norma e shqipes së folur. Parime dhe rregulla.
Java 3:	Rruga dhe faktorët e zhvillimit të normës drejtshqiptimore. Baza dialektore fonetike e normës së shqipes së folur.
Java 4:	Rregullat e drejtshqiptimit. Zanoret gojore. Seria e zanoreve hundore. Drejtshqiptimi i zanoreve dhe i togjeve të zanoreve. Shqiptimi i zanoreve të patheksuara. Shqiptimi i ë-së së patheksuara.

Java 5:	Shqiptimi i bashkëtingëlloreve dhe i grupeve të bashkëtingëlloreve.
Java 6:	Shkaqet e shmangies nga shqiptimi standard: Shprehitë dhe veçoritë dialektore të shqiptimit të folësit. Shqiptimi <i>shkronjë për shkronjë</i> i fjalëve të gjuhës së shkruar (ndikimi i shkrimit në shqiptim).
Java 7:	Shkaqet e shmangies nga shqiptimi standard: Shprehitë individuale të shqiptimit. Shqiptimi i shkujdesur. Ndikimi i shqiptimit të gjuhëve të huaja.
Java 8:	Stilet e shqiptimit: neutral, bisedor, solemn ( <i>KOLOKUIUMI 1</i> )
Java 9:	Prozodia dhe njësitë prozodike (mbisegmentare): theksi, intonacioni, tonet, ritmi, kuantiteti. Ndarja e rrjedhës së ligjërimin. Njësitë e rrjedhës së ligjërimin: fraza, sintagma, fjala. Shënuesit ndarës të rrjedhës së ligjërimin: synimi i folësit, stili dhe shpejtësia e të folurit, lidhja kuptimore e fjalëve, konturi melodik, intonacioni, pauzat, spikatja e fjalëve të veçanta, toni, rendi i fjalëve, mjete leksikore, trajta e shquar dhe e pashquar.
Java 10:	Rrokja. Ndarja fonetike e fjalëve në rrokje. Shqiptimi rrokjesor.
Java 11:	Theksi i fjalës në gjuhën shqipe. Koncepti i theksit. Parametrat e theksit. Funkcioni i theksit. Vendi dhe natyra theksore e fjalëve të shqipes. Palëvizshmëria e theksit në gjuhën shqipe.
Java 12:	Fjalët e theksuara (tonike). Fjalët e patheksuara (atone). Fjalët proklitike dhe enklitike. Fjalët me theks dytësor. Prapashtesa të theksuara dhe të patheksuara.
Java 13:	Theksi sintagmatik. Theksi i fjalisë. Theksi logjik. Theksi emocional.
Java 14:	Intonacioni në gjuhën shqipe. Komponentet dhe funksionet gjuhësore të intonacionit.
Java 15:	Veçori të shqiptimit të fjalëve të huazuara relativisht vonë. ( <i>KOLOKUIUMI 2</i> )

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimeve dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.